



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry Of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

**AGJENCIA PËR MBROJTJEN  
E MJEDISIT TË KOSOVËS**

**KOSOVSKA AGENCIJA  
ZA ZAŠTITU SREDINE**

**KOSOVO ENVIRONMENTAL  
PROTECTION AGENCY**

---



## **RAPORT VJETOR PËR GJENDJEN E AJRIT 2020**

## **Hyrje**

Raporti për gjendjen e cilësisë së ajrit në Kosovë ofron një vlerësim të bazuar në të dhënat ekzistuese nga sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit dhe të dhënave për emisionet nga operatorët ekonomik dhe burimet tjera të ndotjes.

Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr.03/L-025, Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga ndotja, Nr.03/L-160 dhe Ligjit për Veprimtarinë Hidrometeorologjike, Nr.02/L-79, AMMK/IHMK është e obliguar që të bëjë monitorimin e cilësisë së ajrit në tërë territorin e Kosovës.

AMMK/IHMK, ka një sistem të monitorimit prej 12 stacioneve dhe 1 stacion mobil. Stacionet monitoruese bëjnë monitorimin e pluhurit grimcor (particulates matter; PM10, PM2.5), NO/NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub> dhe CO.

## **Përmbajtja**

- 1. Baza ligjore dhe rregullative për monitorimin e ajrit**
  - 1.1. Korniza ligjore
  - 1.2. Informimi për kufijtë e alarmit për cilësi të ajrit
  - 1.3. Parakushtet për vlerësimin e të dhënave për cilësi të ajrit
- 2. Cilësia e ajrit**
  - 2.1. Monitorimi i cilësisë së ajrit
  - 2.2. Sistemi për qasje online në të dhënat për cilësisë së ajrit
  - 2.3. Cilësia e ajrit në aglomeracionin AKS1
  - 2.4. Cilësia e ajrit në Zonën ZKS1
  - 2.5. Të dhënat mesatare mujore për PM10 dhe PM2.5
  - 2.6. Trendi i cilësisë së ajrit për vitet 2013-2020
- 3. Vlerësimi i emisioneve ndotëse nga operatorët për vitin 2020**
  - 3.1. Vlerësimi i emisioneve në ajër nga TCA dhe TCB
  - 3.2. Vlerësimi i emisioneve në ajër nga New Co Feronikel
  - 3.3. Vlerësimi i emisioneve në ajër nga SharrCem
- 4. Investimet në përmirësimin e rrjetit për monitorimin e cilësisë së ajrit**
- 5. Konkluzionet dhe rekomandimet**
  - 5.1. Konkluzione
  - 5.2. Rekomandime
- 6. Lista e shkurtesave, figurave dhe tabelave**
  - 6.1. Lista e shkurtesave
  - 6.2. Lista e figurave
  - 6.3. Lista e tabelave

## 1. Baza ligjore dhe rregullative për monitorimin e ajrit

### 1.1. Korniza ligjore

Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr.03/L-160, 2010, është ligji bazë për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Infrastruktura ligjore për mbrojtjen e ajrit nga ndotja është i plotësuar edhe me UA (aktet nenligjore), si:

- ✓ Udhëzim Administrativ (QRK)–Nr.06/2007) mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- ✓ Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.04/2009)për kontrollin e emisioneve të bashke dyzimeve organike, të avullueshme gjatë deponimit, zbrazjes, mbushjes dhe transportimit të karburanteve;
- ✓ Udhëzim Administrativ (ministri i MMPH) Nr.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit;
- ✓ Udhëzim Administrativ-Nr.15/2010 për kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese për cilësinë e ajrit, numrin dhe shpeshtinë e matjeve, klasifikimin e ndotësve të cilët monitorohen, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të të dhënave;
- ✓ Udhëzim administrativ (QRK)-Nr.21/2013 për arsenin, kadmiumin, merkurin , nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajër;
- ✓ Udhëzim Administrativ (QRK) Nr.16/2013 për substancat, që e dëmtojnë shtresën e ozonit dhe gazrat serrë të fluoruara;
- ✓ Udhëzim Administrativ (QRK)-Nr.19/2013 për qasje në informata për shpenzimin ekonomik të karburanteve dhe emisionin CO<sub>2</sub> të automjeteve të reja personale;
- ✓ Udhëzim Administrativ (QRK)-Nr.01/2016 për mekanizmin e përcjelljes së emisioneve të gazrave serë;
- ✓ Udhëzim Administrativ (QRK) -Nr.08/2016 për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme të ndotjes.

## 1.2. Informimi për kufijtë e alarmit për cilësi të ajrit

Informimi dhe kufijtë e alarmit për cilësi të ajrit janë të përcaktuar sipas Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr.03/L-160 dhe UA 02/2011 për Normat e Cilësisë së Ajrit (Tab.1,2,3).

**Tabela 1. Pragjet alarmuese për dyoksidin e squfurit (SO<sub>2</sub>) dhe dyoksidin e azotit (NO<sub>2</sub>)**

Ndotësi	Pragu alarmues
Dyoksid sulfurit(SO <sub>2</sub> )	500 µg/m <sup>3</sup>
Dyoksid azoti(NO <sub>2</sub> )	400 µg/m <sup>3</sup>

**Tabela 2. Pragjet e alarmit për PM10 dhe Ozon (O<sub>3</sub>)**

Qëllimi	Periodha mesatare	Pragu alarmues
<b>PM10</b>		
Informatat	24-orë	100 µg/m <sup>3</sup>
Alarmi	24-orë	100 µg/m <sup>3</sup> (për 3 ditë rradhazi)
<b>O<sub>3</sub></b>		
Informatat	1-orë	180 µg/m <sup>3</sup>
Alarmi	1-orë	240 µg/m <sup>3</sup>

**Tabela 3. Normat e cilësisë së ajrit (UA Nr.02/2011)**

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera kufitare µg/m <sup>3</sup>	Tejkalimet e lejuara brenda vitit
NO <sub>2</sub>	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e vegetacionit	µg/m <sup>3</sup>	30	Nuk parashihet
SO <sub>2</sub>	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore te maksimales 8-orëshe, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	10	Nuk parashihet
PM10	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	50	35
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	40	Nuk parashihet
PM2.5	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	25	Nuk parashihet
O <sub>3</sub>	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m <sup>3</sup>	120	Nuk parashihet

Në tabelen nr. 4 është paraqitur indeksi i cilësisë së ajrit për ndotësit e ajrit, si dhe niveli i indexit dhe ndikimi në shëndet.

**Tabela 4. Indeksi i cilësisë së ajrit për parametrat e monitoruar**

Cilësia	Shumë e Mirë	E Mirë	E moderuar	E pashëndetshme	E rrezikshme për shëndetin
Grimcat e pluhurit më të vogla se 2.5 µm (PM <sub>2.5</sub> )	0-10	10-20	20-25	25-50	50-800
Grimcat e pluhurit më të vogla se 10 µm (PM <sub>10</sub> )	0-20	20-35	35-50	50-100	100-1200
Dioxidi i azotit (NO <sub>2</sub> )	0-40	40-100	100-200	200-400	400-1000
Ozoni (O <sub>3</sub> )	0-80	80-120	120-180	180-240	240-600
Dioxidi i sulfurit (SO <sub>2</sub> )	0-100	100-200	200-350	350-500	500-1250
Niveli i Indexit të Cilësisë së ajrit (bazuar në përqendrimin e ndotësve, shprehur në µg/m <sup>3</sup> )					

### 1.3. Parakushtet për vlerësimin e të dhënave për cilësi të ajrit

Për vlerësimin e të dhënave për cilësi të ajrit është e domosdoshme të merren në konsideratë edhe informacionet tjera si parakushte për një vlerësim real të gjëndjës së ajrit, si:

- Përshkrimi i lokacionit (pozicioni i stacionit monitorues, orografia, objektet e banimit për rreth, objektet industriale, infrastruktura rrugore, trafiku, sfondi i stacionit dhe të dhëna tjera, të cilat e pasqyrojnë situatën gjegjëse në kohë dhe hapësirë);
- Kontinuiteti i matjeve 24-orëshe dhe matjeve mujore-jo interpretim i një vlere të një çasti;
- Temperatura, °C;
- Shtypja; mbar ose hPa;
- Lagështia relative e ajrit, %;
- Shpejtësia e ajrit, m/s;
- Reshjet;
- Trëndafil i erës për kohën e vlerësimit të të dhënave;
- Ndikimi i ndotjes ndërkufitare nga shtetet e rajonit.

## 2. Cilësia e ajrit

### 2.1. Monitorimi i cilësisë së ajrit

**Monitorimi i cilësisës së ajrit është ndar në dy zona:**

- **Aglomerat-AKS1** (Prishtina IHMK dhe Rilindja, Obiliqi, Dardhishtë dhe Palaj), dhe
- **Zona ZKS1** (Gjilani, Peja, Prizreni, Drenasi, Brezovica, Mitrovica dhe Hani i Elezit) (Tab.nr.5).

Pra rrjeti nacional i monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë posedon 12 stacione fikse dhe një (1) stacion mobil të monitorimit automatik të cilësisë së ajrit (shih tab.5).

**Tabela 5. Stacionet monitoruese për cilësinë e ajrit, Aglomeracioni AKS 1 dhe Zona ZKS 1**

Aglomeracioni	Emërtimi i Stacionit monitorues	Shenja e Stac. Code	Lokacioni	Parametrat që maten	Lloji i stacionit	Data e funksionali zimit	
AKS 1	1	IHMK	KS0101	Prishtinë	PM10,PM2.5,SO <sub>2</sub> , NO <sub>x</sub> ,O <sub>3</sub> ,CO	Sfondi urban	09.01.2009
	2	Rilindja	KS0102	Oborri i Rilindjes,	PM10,PM2.5,O <sub>3</sub> ,SO <sub>2</sub> ,CO,NO <sub>2</sub>	Sfondi urban	06.05.2010
	3	Obiliqi	KS0110	QMF	PM10,PM2.5,SO <sub>2</sub> , NO <sub>x</sub> ,O <sub>3</sub> ,CO	Sfondi urban	01.03.2013
	4	Dardhishtë	KS0111	Shkolla fillore	PM10,PM2.5,SO <sub>2</sub> , NO <sub>x</sub> ,O <sub>3</sub> ,CO	Sfondi urban/industrial	01.03.2013
	5	Palaj	KS0112	Kosova Mont	PM10,PM2.5,SO <sub>2</sub> , NO <sub>x</sub> ,O <sub>3</sub> ,CO	Sfondi industrial	01.03.2013
ZKS 1	6	Pejë	KS0305	Sh. F. "Lidhja e Prizrenit"	PM2.5,PM10,NO <sub>x</sub> ,O <sub>3</sub> ,SO <sub>2</sub> ,CO	Sfondi urban	04.04.2012
	7	Prizren	KS0406	Kuvendi Komunal	PM2.5,PM10,NO <sub>x</sub> ,O <sub>3</sub> ,SO <sub>2</sub> ,CO	Sfondi urban	01.04.2012
	8	Hani i Elezit	KS0508	Sh.fillore "Ilaz Hallaqi"	PM2.5,PM10,NO <sub>x</sub> ,O <sub>3</sub> ,SO <sub>2</sub> ,CO	Sfondi urb./ind.	05.04.2012
	9	Gjilan	KS0609	Kuvendi Komunal	PM2.5,PM10,NO <sub>x</sub> ,O <sub>3</sub> ,SO <sub>2</sub> ,CO	Sfondi urban	01.04.2012
	10	Drenas	KS0103	Kuvendi Komunal	PM2.5,PM10,NO <sub>x</sub> ,O <sub>3</sub> ,SO <sub>2</sub> ,CO	Sfondi urban	05.04.2011
	11	Mitrovicë	KS0204	Stacioni i meteorologjisë	PM2.5,PM10,NO <sub>x</sub> ,O <sub>3</sub> ,SO <sub>2</sub> ,CO	Sfondi urban	/06.2013
	12	Brezovicë	KS0507	Zona e skijimit	PM2.5,PM10,NO <sub>x</sub> ,O <sub>3</sub> ,SO <sub>2</sub> ,CO		

## 2.2. Sistemi për qasje online në të dhënat për cilësisë së ajrit

AMMK ka lansuar sistemin për raportimin online të rezultateve për cilësi të ajrit që monitorohen nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.

Në sistemin e të dhënave për cilësi të ajrit në kohë reale mundësohet qasje duke klikuar direkt në linkun e sistemit të të dhënave në web faqen e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës;

<http://ihmk-rks.com/t/?page=1,5> ,

Apo edhe përmes linkut:

<http://kosovoairquality.rks-gov.net/secure/index2.html>

AMMK do të vazhdoj të bëjë informimin dhe raportimin për cilësi të ajrit përmes raporteve mujore, raporteve dhe vlerësimeve periodike e vjetore si dhe përmes informatave shitesë për publikun në raste të tejkalimeve të pragjeve për informim apo pragjeve alarmuese për parametra të caktuar siç është e përcaktuar me ligj.

## 2.3. Cilësia e ajrit në aglomeracionin AKS1 (Zona e Prishtinës)

**Vlerat mesatare të PM10 kanë treguar** tejkalime mbi vlerat kufitare ( $40 \mu\text{g}/\text{m}^3$ ) në stacionet monitories: IHMK, Rilindje, Obiliq dhe Dardhishtë. Tejkallimet ishin me të theksuara gjatë muajve janar dhe nëntor. Shih (tab.6).

**Tabela 6. Mesataret mujore të PM10 në Aglomeracionin AKS1, 2020**

Muaji	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor	Mes.2020
IHMK	58.2	32.4	38.1	26.1	25.7	18.8	19.7	21.3	22.6	31.8	63.4	34.6	32.73
Rilindje	60.8	50	45.1	27.8	28.5	20.9	21.9	23.7	24.3	36.3	62.8	42.3	37.03
Palaj	35.6	23.9	20.7	20.1	14.5	8.9	9.8	11.1	10.8	15.8	28.7	18.6	18.21
Obiliq	60.1	41.1	33.6	25	21.1	15.6	12.3	14.9	15.7	30.4	50.9	37.3	29.83
Dardhishtë	65.4	41.1	36.4	34	23.3	14.7	17.3	17.3	20.3	24.6	45.2	25.4	30.42

Vlerat mesatare vjetore të PM10 në Aglomeracionin AKS 1, kanë qënë nën vlerën e lejuara sipas standardit (fig.1).





Figura 1. Vlerat mesatare vjetore të PM10 në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020

**Vlerat e PM 2.5** kanë qënë me tejkalime të vlerave kufitare (25 µg/m<sup>3</sup>). Vlerat me te larta të theksuara kanë rezultuar gjatë muajve janar, shkurt, nëntor dhe dhjetor, në stacionet e IHMK, Rilindje, Obiliq dhe Dardhishtë. Shih ( tab.7).

**Tabela 7. Vlerat mesatare mujore te PM2.5 në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020**

Muaji	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nentor	dhjetor	Mes.2020
IHMK	47.5	25	24.7	17.3	12.8	10.3	11.5	13	12	21	51.2	29.5	22.98
Rilindje	48	32.9	27.4	18.7	13.4	10.4	11.4	12.5	11.5	21.1	46.2	32.5	23.83
Palaj	28.8	16.3	13.9	11.5	7.8	5.5	6.4	8	7.1	12.3	25.4	15.4	13.20
Obiliq	51.3	29.5	22.8	15.7	10.9	8.3	7.9	9.8	8.9	20.6	41.5	30	21.43
Dardhishte	52.4	31	23.1	18.1	11.9	7.8	9.1	10.5	9.4	17.3	38.3	22.7	20.97

Në fig.6, janë të paraqitura vlerat mesatare vjetore të PM2.5 në Aglomeracionin AKS1. Vlerat mesatare vjetore të PM 2.5 kanë qënë nën vlerat e lejuara. Shih (fig.2.)



*Figura 2. Vlerat mesatare vjetore të PM2.5 në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020*

**Parametri i Ozonit** në Aglomeracionin AKS1, nuk pa patur tejkalime mbi vlerat kufitare e cila është e lejuar 120 µg/m<sup>3</sup>. Shih (tab.8)

**Tabela 8. Mesatarja vjetore e Ozonit në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020**

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes.2020
IHMK	15.4	40.3	61.8	75.5	58.1	47.5	57.2	48.6	50.3	26.3	16.5	23.2	43.39
Rilindje	19.1	31.6	57.8	80.4	64.1	72.3	63.4	57	58.8	28.8	20.3	23.9	48.13
Palaj	37.5	51.8	57.6	64.9	59.5	54.8	64.4	59.3	61	38.5	1.3	26.7	48.11
Obiliq	13.9	25.8	30.5	32.1	23.6	49.7	60.8	54.3	57.2	33.2	22.9	17	35.08
Dardhishte	30.7	44.7	50.3	57.4	54.4	49.6	58.2	51.4	48.3	24.9	17.8	16.7	42.03

Valera mesatare vjetore të Ozonit në Aglomeracionin AKS1, janë me të ulta në krahasim me vlerat e lejuara maksimale (fig. 3).




Figura 3. Vlerat mesatare vjetore te Ozonit në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020

**NO<sub>2</sub>** – Vlerat mesatare mujore mbi nivelin e lejuar janë regjistruar në muajin Janar, në stacionin e monitorimit Rilindja. Në të gjitha stacionet tjera gjatë tërë vitit nuk ka patur vlera mbi standardin e lejuara e cila është 40 µg/m<sup>3</sup>. Shih tabelen 9.

Tabela 9. Mesatarja mujore te NO<sub>2</sub> në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes.2020
IHMK	32.6	28.1	18.3	11.1	14.6	17	13.6	17.7	17.7	25	26.1	20.5	20.19
Rilindje	47.5	39.9	26	14.3	18.6	23.4	18.9	24	25.7	30.4	28.5	16.8	26.17
Palaj	15.3	10.2	7.7	6.3	4.9	4.7	5.3	6.6	6.1	9.3	13.1	12.8	8.53
Obiliq	30.7	23.8	22.4	22.2	20.9	10	9.2	11.2	10.7	15.1	18.5	21.3	18.00
Dardhishte	22.2	15.9	10.8	7.8	7.4	7.1	6.7	8.7	6.9	9.8	11.1	11.6	10.50

Vlerat mesatare vjetore të NO<sub>2</sub> në Aglomeracionin AKS1, kanë rezultuar nën vleren e lejuar. Vlerat me të larta janë regjistruar në stacionin e Rilindjes, ku vlerat mesatare vjetore arrijnë deri në 26 µg/m<sup>3</sup> (fig.4.)





Figura 4. Mesataret vjetore te NO<sub>2</sub> në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020

**SO<sub>2</sub>** – Vlerat mesatare mujore të këtij parametri janë nën vlerave kufitare të lejuara (120 µg/m<sup>3</sup>). Në të gjitha pikat monitoruese të Aglomeracionit vlerat e SO<sub>2</sub> gjatë tërë vitit kanë qënë me të ulta krahasim me standardet e lejuara (tab.10).

**Tabela 10. Mesataret mujore te SO<sub>2</sub> në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020**

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes.2020
IHMK	17.3	14.6	15.5	17.2	14	13.6	10	8.9	10.4	11.2	15.4	17	13.76
Rilindje	15.7	11.6	12.4	11.9	8.4	9.8	9.2	10.9	11.3	12.3	9.8	8.2	10.96
Palaj	9.5	4.7	4.5	4.4	59.5	5	8.1	8.2	8	9.3	12.5	11.8	12.13
Obiliq	13.5	10.1	10.2	10.1	10.9	15.2	20.6	20.2	21.6	9.7	17.6	15.7	14.62
Dardhishte	21.4	17.5	18.5	18	17.5	17.4	21.1	21.1	13.1	3.3	6.9	8.5	14.81

Vlerat mesatare vjetore të SO<sub>2</sub> në Aglomeracionin AKS1, janë shumë me te ulta në të gjitha stacionet nese merret për bazë standardi i lejuar (fig.5).




*Figura 5. Mesataret vjetore te SO<sub>2</sub> në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020*

**CO** – Në të gjitha stacionet monitoruese vlerat mesatare mujore janë të ulta në krahasim me vlerat kufitare (10 mg/m<sup>3</sup>). Vlera me e lartë është në stacionin e Dardhishtës 7.9 µg/m<sup>3</sup>, por nën vlerën e lejuar. Shih (tab. 11).

**Tabela 11. Mesataret vjetore te CO në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020**

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes.2020
IHMK	3	3	3.5	4.1	1.3	0.7	0.7	1.3	0.7	1.3	1.7	1.4	1.89
Rilindje	3.6	3.2	2	1.8	1.9	1.3	0.3	0.6	0.7	0.7	1.3	1.3	1.64
Palaj	0.4	0.3	0.2	0.1	0.2	0.1	0.4	0.3	0.1	0.2	0.4	0.3	0.25
Obiliq	2.4	2	2	2	2	2	1.8	0.4	0.4	0.8	1.5	1.3	1.55
Dardhishte	7.9	3.5	1.8	1.8	0.5	0.7	1.1	1.7	1.3	0.9	1.7	1.4	2.03

Vlerat mesatare vjetore të CO në Aglomeracionin AKS1, tregojnë se nuk ka patur tejkalime nga standardi i lejuar (fig. 6).



*Figura 6. Mesataret vjetore te CO në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020*

Ditët me tejkalime për PM10 gjatë vitit 2020, në Aglomeracionin AKS1 janë regjistruar 280 ditë. Numri me i lartë i ditëve me tejkalime te vlerave me PM10 janë regjistruar në IHMK, Rilindja, Obiliq dhe Dardhisht. Keto tejkalime kanë qenë në sezonin dimër/vjeshtë/pranverë (tab. 12).

**Tabela 12. Ditët me tejkalime për PM10 gjatë vitit 2020**

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	2020
IHMK	16	4	7	1	2	0	0	0	0	5	17	7	59
Rilindje	15	14	10	1	3	0	0	0	0	6	19	8	76
Obiliq	18	9	6	0	2	0	0	0	0	4	11	7	57
Dardhishtë	18	6	27	7	1	0	0	0	0	3	6	4	72
Palaj	7	3	2	0	0	0	0	0	0	0	4	0	16
Gjithsej	74	36	52	9	8	0	0	0	0	18	57	26	280

## 2.4. Cilësia e ajrit në Zonën ZKS1


Zona ZKS1 përfshin territorin e monitoruar për cilësinë e ajrit në këto qendra: Drenas, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Hani i Elezit, Gjilani, dhe Brezovicë. Në këtë zonë është monitoruar cilësia e ajrit me këto parametra; PM10, PM 2.5, O<sub>3</sub>, NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub> dhe CO.

**PM10** – Gjatë muajve janar, dhe nëntor, të vitit 2020 kishte tejkalime të vlerave kufitare (40 µg/m<sup>3</sup>) pothuajse në të gjitha stacionet monitoruese, kurse gjatë shkurtit dhe marsit në Gjilan, dhe gjatë muajit shkurt në Pejë (shih tab.13).

**Tabela 13. Mesataret mujore te PM10 në ZKS1 gjatë vitit 2020**

	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nentor	dhjetor	Mes.2020
Drenas	58.2	27.4	37.7	23.1	15.6	10.2	14.1	15.5	16.2	21.2	46.6	29.9	26.31
Mitrovicë	58.2	37.8	37.4	28.4	22	13	14.3	15.8	16.1	24.1	44.9	37.6	29.13
Pejë	85.3	43.8	33.7	25.5	24.1	14.7	16.6	18.3	18.8	27.8	71.2	53.5	36.11
Prizren	66.6	30.4	28	19.5	17.7	10.5	14.3	14.6	17.4	22.5	56.8	57	29.61
Hani i Elezit	41	31.7	33.6	23.4	11.8	8.1	13.7	16.4	19.3	23.6	44.4	36.8	25.32
Gjilan	94.3	63.2	54.8	31.6	29.7	21.1	20.1	19.8	13.7	26.9	57.8	40	39.42
Brezovicë	2.9	3.8	9.7	9.7	11.1	6.1	10.2	11.1	12.7	5	6	2	7.53

Nëse merren në vlerësim vlerat mesatare vjetore të PM10 për vitin 2020 në Zonën ZKS1, shihet se nuk ka pasur tejkalime nga standardi i lejuar. Afër vlerave të lejuara është regjistruar në Stacionin e Gjilanit, ku vlera mestare vjetore është 39.42 µg/m<sup>3</sup> (fig. 7).



*Figura 7. Mesataret vjetore te PM10 në ZKS1 gjatë vitit 2020*

**PM2.5** –Tejkalime të vlerave kufitare për PM2.5 (25 µg/m<sup>3</sup>) ka pasur në të gjitha stacionet monitoruese gjatë muajve janar, shkurt, nëntor dhe dhjetor të vitit 2020 (tab.14).

**Tabela 14. Mesataret mujore te PM2.5 në ZKS1 gjatë vitit 2020**

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes.2020
Drenas	47.3	21.5	24.1	16.2	8.9	6.2	9.2	10.3	9.6	15.2	38	26.2	19.39
Mitrovicë	48.3	28.9	24.6	20.4	12	7.3	9.2	10.5	10.8	19.2	39.6	33.9	22.06
Pejë	72.7	34.2	25.3	19.1	12.9	8.4	11.2	12.7	12.2	22.5	61.4	49.8	28.53
Prizren	56.1	22.8	6.8	14.1	9.2	5.7	8.4	9.3	9.8	15.3	46.8	46.5	20.90
Hani i Elezit	33.9	23	21.4	14.2	7.7	5.6	8.8	9.8	9.5	14.4	34.1	29	17.62
Gjilan	76.7	48.2	37.6	22.2	14.6	10.4	10.7	11.4	9.9	21.7	52.2	36	29.30
Brezovicë	2.5	3.3	20	7.5	6.4	5.1	8.4	8.5	8.9	3.5	5	1.7	6.73

Vlerat mesatare vjetore te PM2.5 për vitin 2020 në ZKS1, kanë treguar tejkalime në dy stacionet monitoruese; në Pejë dhe në Gjilan (fig. 8).




Figura 8. Mesataret vjetore te PM2.5 në ZKS1 gjatë vitit 2020

**Ozoni** – Gjatë tërë vitit parametri i O<sub>3</sub> ka qënë në vlerat normale dhe pa tejkalime mbi vlerat kufitare të lejuara në të gjitha stacionet, (120 µg/m<sup>3</sup>). Shih tabelen 15.

Tabela 15. Mesataret mujore te Ozonit në ZKS1 gjatë vitit 2020

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes.2020
Drenas	34.8	58.4	62	79.4	68.5	66.5	70.6	63.8	64.4	14.6	3	7.3	49.44
Mitrovicë	32.2	42.3	51.9	53.7	24.2	6.7	11.8	13.4	19.8	18.5	18.7	21.9	25.72
Pejë	13.1	25	28.9	35.5	26.9	25.1	44.4	73	75	39.8	25.3	20.4	38.12
Prizren	35.1	58.2	64.3	85.2	73.7	50.9	82.5	74.7	75.4	40.1	23.7	21.1	59.07
Hani i Elezit	36.9	45.5	52.6	69	54.2	58.3	77.1	70.8	73	37.4	27.1	24.3	53.57
Gjilan	31	44.4	55.1	74.5	66.7	60.4	67.6	61	61	34.3	24.1	27.6	52.43
Brezovice	83.9	83.5	98.8	120.4	109.1	98.8	99.4	101.3	96.8	81.4	64.1	67.1	92.79

Vlerat mesatare vjetore të ozonit për vitin 2020 në Zonën ZKS1, janë shumë me të ulta sesa vlera e lejuar sipas standardeve. Në Brezovicë ky parametër është me vlerë mesatare me e lartë se sa në stacionet tjera, stacion i cili merret si indikator i pastertisë (fig.9).





Figura 9. Mesataret vjetore te Ozonit në ZKS1 gjatë vitit 2020

**NO<sub>2</sub>** – Vlerat mesatare me tejkalime të lehta është regjistruar gjatë muajt maj, 2020, në stacionin e Hanit të Elezit. Në të gjitha stacionet tjera gjatë tërë vitit nuk ka pasur tejkalime të vlerave të lejuara, (40 µg/m<sup>3</sup>). Shih (tab. 16).

**Tabela 16. Mesataret mujore te NO<sub>2</sub> në ZKS1 gjatë vitit 2020**

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes.2020
Drenas	21	13.8	11.5	7.2	7.1	6.7	7.9	11.5	12.3	15.8	19.9	18.3	12.75
Mitrovicë	19.6	14.7	16.1	9.1	12	14.1	13.9	12.5	12.2	12.3	16	17.3	14.15
Pejë	21.9	16.8	11	9.4	8.2	8.7	9	9.5	11	17.4	23.9	24.3	14.26
Prizren	33.1	22	17.1	9.3	10	10.3	8.3	11.1	13.4	21.4	29.1	27.9	17.75
Hani i Elezit	22.2	20.2	17.1	16.1	40.9	11.1	7.2	11	10.3	17	21.2	22.1	18.03
Gjilan	31.8	27.1	18.8	9.3	8.8	10.5	9.4	10.6	16	25.6	28.2	27.7	18.65
Brezovice	1.4	1.9	2.7	2.6	1.7	0.7	1.3	1.2	1.7	0.8	1.5	0.9	1.53

Vlerat mesatare vjetore të NO<sub>2</sub> në të gjitha stacionet monitoruese, kanë rezultuar të ulta në krahasim me vlerat standarde. Shih figuren 10.



*Figura 10. Mesataret vjetore te NO<sub>2</sub> në ZKS1 gjatë vitit 2020*

**SO<sub>2</sub>** – Vlera mesatare mujore të SO<sub>2</sub> në asnjërin prej stacioneve monitoruese të kesaj zone nuk ka pasur tejkalime të vlerave kufitare (125 µg/m<sup>3</sup>) Shih tab. 17.

**Tabela 17. Mesataret vjetore te SO<sub>2</sub> në ZKS1 gjatë vitit 2020**

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes.2020
Drenas	10.9	6.8	6.3	5.1	4.7	7.5	7.9	9.5	4.2	3.8	5	3	6.23
Mitrovicë	46	54	41.6	47.4	80.5	69.2	28.5	22.2	26.5	27.8	30.3	30	42.00
Pejë	6.8	10.9	6.6	7.2	8.1	24.6	2.8	11.6	10.2	13	14.9	5.4	10.18
Prizren	9.5	8.7	6.7	5.3	6.5	6.4	8.1	9.3	12.9	11.1	10.1	5.8	8.37
Hani i Elezit	35.7	2.5	3.5	4	4.3	4.9	6.2	7.4	8.5	7.5	6	8.3	8.23
Gjilan	3.2	2.3	2.7	2.7	1.9	0.8	1.1	10.6	11.5	6.2	10.7	11.5	5.43
Brezovice	2.8	3.1	4.3	4.2	1.4	1.6	4.6	5.8	7.4	7	2.3	2.4	3.91

Ndërsa, vlerat mesatare vjetore te SO<sub>2</sub> për vitin 2020 në Zonën ZKS1, janë trefishi me i ultë i vlerave se sa vlerat standarde ( fig. 11).




Figura 11. Mesataret vjetore te SO<sub>2</sub> në ZKS1 gjatë vitit 2020

CO – Ky parameter matës ka rezultuar me vlera mestare vjetore të ulta gjatë tërë vitit, në të gjitha stacionet monitoruese të zonës ZKS1 (tab. 18).

Tabela 18. Mesataret vjetore te CO në ZKS1 gjatë vitit 2020

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Mes.2020
Drenas	21	0.4	0.3	0.2	0.2	0.1	0.1	0.2	0.2	0.3	0.8	0.8	2.05
Mitrovicë	0.7	0.3	0.2	0.2	0.3	0.2	0.3	0.4	0.2	0.3	0.5	0.5	0.34
Pejë	1.6	0.7	0.3	0.3	0.2	0.2	0.3	0.2	0.3	0.4	1.3	1.3	0.59
Prizren	0.9	0.5	0.4	0.2	0.2	0.2	0.1	0.1	0.2	0.3	1.1	1.4	0.47
Hani i Elezit	0.2	0.3	0.3	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.4	0.4	0.19
Gjilan	1.5	0.9	0.5	0.3	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.5	1.2	1	0.53
Brezovice	0.3	0.2	0.2	0.2	0.2	0.1	0.2	0.3	0.3	0.4	0.5	0.5	0.28

Vlerat mesatare vjetore te CO, për vitin 2020 në ZKS1, kanë qenë disa herë më të ulëta në krahasim me vlerat standarde ( fig. 12).




Figura 12. Mesataret vjetore te CO në ZKS1 gjatë vitit 2020


Në zonën ZKS1, tejkalime të vlerave gjatë vitit 2020 janë regjistruar 323 ditë. Këto tejkalime kanë qenë me te theksuara gjatë stinëve dimër/vjeshtë/pranverë (tab.19).

**Tabela 19. Ditët me tejkalime për PM10 gjatë vitit 2020**

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	2020
Drenas	13	4	5	0	0	0	0	0	0	3	11	4	40
Mitrovicë	17	9	6	1	2	0	0	0	0	0	9	6	50
Pejë	26	8	4	0	3	0	0	0	0	2	20	14	77
Prizren	17	3	3	0	1	0	0	0	0	2	10	13	49
Hani i Elezit	8	4	4	0	0	0	0	0	0	0	11	4	31
Gjilan	19	17	13	1	2	0	0	0	0	3	15	5	75
Brezovice	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
Gjithsej	100	45	35	2	9	0	0	0	0	10	76	46	323

## 2.5. Të dhënat mesatare mujore për PM10 dhe PM2.5 për stacionet veç e veç për vitin 2020

Në vijim janë prezantuar të dhënat për këta dy parametra për secilin stacion dhe muajt për vitin 2020. Në fund të secilit grafik paraqiten mesataret mujore të PM10 dhe PM2.5 me ngjyra përkatëse, bazuar në standardet e BE për AQI (Air Quality Index). Shih fig.13.



*Figura 13. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në Stacionin e IHMK-së*

Sipas fig.13 tejkalime të vlerave kufitare të PM10 në stacionin e monitorimit të ajrit në IHMK, kishte vetëm në janar dhe nëntor, kurse për PM2.5 kishte në muajt; janar, nëntor, dhjetor.

Në këta muajt të vitit përsëritet nivel më i lartë i ndotjes së ajrit për shkak të trafikut urban, ngrohja me lëndë djegëse (thëngjilli, druri, peleti, derivate të naftës etj).

Në stacionin e monitorimit pranë ndërtesës së qeverisë- ish Rilindja, PM10 ka treguar tejkalim të vlerave në muajt janar, shkurt, mars, nëntor dhe dhjetor, të vitit 2020. Ndërsa PM2.5 tejkalim të vlerave ka pasur në janar, shkurt, mars, nëntor dhe dhjetor. Kjo tregon se gjatë stinëve vjeshtë-dimër, këto parametra ndotës kanë ngritje të vlerave (fig.14).




Figura 14. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Rilindjes

Në stacionin e monitorimit në Obiliq, vlerat mesatare mujore me të ngritura për parametrin e PM10, kanë rezultuar gjatë muajve janar, shkurt, nëntor. Vlerat mesatare me të larta të PM2.5 janë regjistruar gjatë muajve janar, shkurt, nëntor dhe dhjetor (shih fig.15).




Figura 15. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Obiliqit

Në stacionin e monitorimit të Dardhishtës, tejkalime të vlerave kufitare të PM10 ka pasur gjatë muajve janar, shkurt, mars, prill dhe nëntor, ndërsa PM2.5 vlerat me të larta janë regjistruar gjatë muajve janar, shkurt dhe nëntor (fig.16).




Figura 16. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Dardhishtës

Në stacionin tjetër të Komunës së Obiliqit në Palaj, vlerat mesatare mujore të PM10 ka treguar vlera me të larta gjatë muajve Janar dhe Nëntor, ndërsa PM2.5 kishte tejkalime gjatë muajve janar dhe nëntor ( fig 17).




Figura 17. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Palaj

Në qytezën e Drenasit, tejkalime të vlerave kufitare të PM10 janë regjistruar gjatë muajve janar dhe nëntor. PM2.5 është regjistruar me tejkalime gjatë muajve janar, nëntor dhe dhjetor (fig.18).




Figura 18. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Drenasit

Në Mitrovicë, stacioni monitorues ka regjistruar tejkalime të vlerave të PM10 gjatë muajve janar dhe nëntor, ndërsa PM2.5 ka pasur tejkalime janar, shkurt, nëntor dhe dhjetor (fig 19).




Figura 19. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Mitrovicës

Në stacionin monitorues në Pejë, tejkalime të vlerave kufitare të PM10 ka pasur gjatë muajve janar, shkurt, nëntor dhe dhjetor. PM2.5, kishte ngritje mbi vlerat standarde janar, shkurt, nëntor dhe dhjetor (fig. 20).




Figura 20. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në Stacionin e Pejës

Në stacionin e monitorimit në Prizren, PM10 dhe PM2.5 ka pasur tejkalime të vlerave të lejuara gjatë muajve janar, nëntor dhe dhjetor (fig. 21).




Figura 21. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në Stacionin e Prizrenit

Në stacionin monitories të Hanit të Elezit, PM10 është regjistruar me vlera me të lartë gjatë muajve janar dhe nëntor, ndërsa PM2.5 gjatë muajve janar, nëntor dhe dhjetor (fig. 22).




Figura 22. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në Stacionin e Hanit të Elezit

Nese merren parasysh vlerat mestare mujore të PM10 për të gjitha stacionet, vrehet se stacioni në Pejë dhe Gjilan rezultojnë me vlera me te larta te regjistrimit, në veçanti , gjatë muajve janar dhe nëntor (fig. 23).




Figura 23. Vlerat mestare mujore për PM10 gjatë vitit 2020 për te gjitha stacionet monitorues

Nëse merren si krahasim vlerat mesatare mujore të PM2.5 për të gjitha stacionet, shihet se stacionet monitoruese per Gjilan dhe Pejë, kanë regjistruar vlera me të larta krahasim me tjerat stacione, sidomos gjatë muajve janar dhe shkurt (fig. 24).




Figura 24. Vlerat mesatare mujore te PM2.5 për të gjitha stacionet për vitin 2020

## 2.6. Trendi i cilësisë së ajrit për vitet 2013-2020

Bazuar në të dhënat që posedojmë për vitet 2013-2020, janë kalkuluar mesataret vjetore për SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub>, CO, PM10 dhe PM2.5 në nivel vendi. Trendi i paraqitur në formë grafikonesh nxjerr në pah tendencën e rënjes të disa paramtrave veçanerisht të PM10, PM2.5.

Është e vështir të diskutohen shkaqet e këtyre trendëve, me faktin se në vitet 2013 deri 2017 nuk kishte matje kontinuale të të gjitha paramtrave. Viti 2018 - 2019, karakterizohen me mbulueshmëri të kënaqshme (mbi 75 %), ndërsa viti 2020 ka qenë shumë i suksesshëm.

Nese vlersohet trendi i vlerave të SO<sub>2</sub> në nivel vendi vrehet se në vitin 2018 kemi pasur një ngritje të tyre, ndersa dy vitet e fundit kemi nje rënie të këtij trendi (fig.25).




Figura 25. Trendi i vlerave të SO<sub>2</sub> për vitet 2013-2020

Trendi i vlerave të NO<sub>2</sub>, në nivel vendi tregojnë se që nga viti 2018 kemi një rënie shumë progresive të vlerave te këtij ndotësi (fig. 26).




Figura 26. Trendi i vlerave të NO<sub>2</sub> për vitet 2013-2020

Parametri i O<sub>3</sub> gjatë këtyre viteve ka variruar prej një viti në vitin tjetër. Kështu që gjatë viteve 2018-2020, kemi një vlerë konstante pa ndonjë ngritje apo ulje të theksuar të vlerave ( fig.27).




Figura 27. Trendi i vlerave të O<sub>3</sub> për vitet 2013-2020

Trendi i levizjes së CO, tregon një tendence të uljës së vlerave që nga viti 2018-2020 (fig.28).




Figura 28. Trendi i vlerave të CO për vitet 2013-2020

Trendi i levizjes së parametrave të PM10, ka ndryshuar nga viti në vit, por që nga viti 2018 kemi një rënie e nivelit të koncentrimit të këtij ndotësi, e cila rënie është përcjellur edhe gjatë vitit 2019, 2020 (fig.29).





Figura 29. Trendi i vlerave të PM10 për vitet 2013-2020

Gjithashtu, edhe për parametrin PM2.5, gjatë viteve 2013-2020, kemi një variacion të vlerave. Që nga viti 2018, kemi një përmirësim të dukshëm të gjëndjës më këtë parametër ndotës (fig. 30).



*Figura 30. Trendi i vlerave të PM2.5 për vitet 2013-2020*

### 3. Vlerësimi i emisioneve ndotëse nga operatorët për vitin 2020

#### 3.1. Vlerësimi i emisioneve në ajër nga TCA dhe TCB

Vlerësimet e të dhënave për emisionet në ajër nga termocentralet A&B, janë bërë për parametrat SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe pluhurit.

Normat e lejuara për emisionet ndotëse sipas Direktivës 2001/80/EC, si dhe UA Nr.06/2007 nga burimet e pa lëvizshme të ndotjes me djegie të madhe janë;

- SO<sub>2</sub>.....400 mg/Nm<sup>3</sup>
- NO<sub>x</sub>.....500 mg/Nm<sup>3</sup>
- Pluhur.....50 mg/Nm<sup>3</sup>

Në TC Kosova A parametrat e SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> dhe CO<sub>2</sub> janë kalkuluar (përveç emisionit të pluhurit, i cili matet) ndërsa në TCB janë të kalkuluar të gjithë parametrat.

#### Emisionet e Pluhurit në TC A dhe TC B

Nga vlerësimi i të dhënave vrehet se në Termocentralin A nuk ka pasur tejkalime nga vlerat kufitare të emisioneve të pluhurit. Në Termocentralin B gjatë gjithë vitit 2020, kemi pasur tejkalime të larta të vlerave të lejuara sipas standardeve ( fig.31).





Figura 31. Vlerat mesatare të emisionet te pluhurit në TCA dhe TC B 2020

#### Emisionet e SO<sub>2</sub> në TC A dhe TC B


Vlerat e emisioneve të SO<sub>2</sub> për të dy termocentralet kanë treguar tejkalime mbi vlerat e lejuara gjatë gjithë vitit. Vlerat shume me te larta të emisioneve të SO<sub>2</sub> janë regjistruar gjatë muajve shkurt, mars, shtator, tetor, duke përfshirë muajt tjerë edhe pse ishin mbi vlerat e lejuar (fig.32).



*Figura 32. Vlerat mesatare të emisionet te SO2 në TCA & TC B 2020*

### Emisionet e NOx në TC A dhe TC B

Shkarkimet e emisioneve te NOx në TC A dhe TC B, kanë qenë mbi vlerat e lejuara gjatë gjithë vitit. Në Termocentralin B, ka pasur shkarkime më të larta te NOx në krahasim me Termocentralin A. Këto vlera kanë shkuar edhe mbi 800 mg/Nm<sup>3</sup> ( fig.33).



*Figura 33. Emisionet e NOx në TCA dhe TC B janar – dhjetor 2020*

### 3.2. Vlerësimi i emisioneve në ajër nga New Co Feronikel

Në Feronikel, për arsye të remontit dhe disa investimeve të përgjithshme të bëra në fabrikë, prodhimi është ndaluar në tërësi nga 01 korriku deri kah fundi i muajit shtator. Si rezultat i kësaj nuk ka patur matje për këto tre muaj ( korrik – shtator 2020).

Vlerat kufitare të emisionit (VKE) sipas UA 06/2007 dhe “Lejes Mjedisore të Integruar” për Ferronikelin janë paraqitur në Tab.20.

Tabela 20. Vlerat kufitare te emisioneve sipas UA 06/2007 dhe “Lejes Mjedisore të Integruar” për Ferronikelin

Substancat ndotëse	Vlera (mg/Nm <sup>3</sup> )
Pluhuri	30
CO	1000
SO <sub>2</sub>	600
NO <sub>x</sub> (NO <sub>2</sub> )	350

Emisionet ndotëse të Feronikelit janë monitoruar dhe vlerësuar nga burimet, siç janë;

1. Oxhaku i furrës rrotulluese;
2. Oxhaku i onvertorëve;
3. Oxhaku i furrës elektrike 1 pas skruberit
4. Oxhaku i furrës elektrike 2 (nuk ka matje pasi nuk është në operim që nga nëntori 2015 ) gjatë tetorit, nëntorit dhe dhjetorit gjatë vitit 2020 ka pasur matje .

#### Emisionet e pluhurit në furrën rrotulluese

Vlerat mesatare mujore të emisioneve të pluhurit në furrën rrotulluese tregojnë se nuk ka pasur tejkalime mbi vlerat kufitare të lejuara gjatë vitit 2020 ( fig.34).




Figura 34. Vlera mesatare mujore e emisioneve të pluhurit në furrën rrotulluese - 2020

## Emisionet e CO në furrën rrotulluese

Gjatë vitit 2020, vlerat mesatare të CO tregojnë se nuk ka pasur tejkalime mbi vlerat e lejuara (fig.35).




Figura 35. Vlera mesatare mujore të emisioneve të CO në furrën rrotulluese - 2020

## Emisionet e SO<sub>2</sub> në furrën rrotulluese

Vlerat mesatare mujore të SO<sub>2</sub> në furrën rrotulluese, tregojnë se nuk kanë pasur tejkalime nga vlerat kufitare të lejuara gjatë vitit 2020 ( fig.36).




Figura 36. Vlera mesatare mujore e emisioneve të SO<sub>2</sub> në furrën rrotulluese - 2020

### Emisionet e NO<sub>2</sub> në furrën rrotulluese

Në furrën rrotulluese sipas vlerësimeve të dhënave mesatare mujore, nuk ka pasur tejkalim të vlerave të emisioneve të NO<sub>2</sub> ( fig.37).




Fig.37. Vlera mesatare mujore e emisioneve të NO<sub>2</sub> në furrën rrotulluese - 2020

### Emisionet e pluhurit në Konvertor

Në figurën 38, janë paraqitur vlera mesatare mujore e pluhurit në konvertor ,ku shihet se nuk ka tejkalime të vlerave kufitare të lejuara gjatë vitit 2020.




Fig.38. Vlera mesatare mujore e emisioneve të pluhurit në konvertor - 2020

### Emisionet e CO në konvertor

Vlera mesatare mujore te CO në konvertor, tregojnë se nuk ka patur tejkalime nga vlerat kufitare të lejuara gjatë vitit 2020 ( fig.39).




Fig.39. Vlerat mesatare mujore e emisioneve të CO në konvertor - 2020

### Emisionet e SO2 në konvertor

Në figurën 40, janë paraqitur vlera mesatare mujore e SO<sub>2</sub> në konvertor, ku shihet se nuk ka pasur tejkalime nga vlerat kufitare të lejuara gjatë vitit 2020.




Fig.40. Vlera mesatare mujore e emisioneve të SO2 në konvertor janar - dhjetor 2020

## Emisionet e NO2 në konvertor

Vlera mesatare mujore te NO2 në konvertor, tregojnë se nuk ka pasur tejkalime nga vlerat kufitare të lejuara gjatë 2020 (fig.41).




Fig.41. Vlera mesatare mujore e emisioneve të NO2 në konvertor - 2020

## Emisionet e pluhurit në furrën elektrike nr.1 pas skruberit

Në figurën 42, janë paraqitur vlera mesatare mujore te pluhurit në konvertor gjatë muajve janar-qershor 2020, dhe ku shihet se nuk ka tejkalime nga vlerat e lejuara. Matje të këtij emisioni nuk ka pasur gjatë muajve korrik-dhjetor.




Fig.42. Vlerat mesatare mujore te emisioneve të pluhurit në furrën elektrike 1- 2020.

## Emisionet e pluhurit në furrën elektrike nr. 2

Furra elektrike 2 nuk ka qenë në operim që nga nëntori 2015. Furra elektrike 2 ka filluar të vëhet në funksion pas ndërprerjës së operimit të furrës 1 si pasojë e remont. Furra elektrike 2 ka startuar të funksionoj gjatë tetorit-dhjetorit të 2020, ku edhe ka pasur matje. Vlerat mesatare mujore të pluhurit për muajt tetor-dhjetor, 2020, pa tejkalime mbi vlerën e lejuar (fig. 43).




Fig.43. Vlerat mesatare mujore te emisioneve të pluhurit në furrën elektrike 2- 2020

### 3.3. Vlerësimi i emisioneve në ajër nga SharrCem

Më poshtë janë paraqur në mënyrë grafike emisionet e Pluhurit, SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> në Sharrcem, për vitin 2020.

#### Emisionet e pluhurit

Emisionet e pluhurit janë vlerësuar nga dy burime të operatorit SharrCemit;

- Emisionet e pluhurit të furra - mulliri i lëndës së parë;
- Emisionet e pluhurit te ftohësi i klinkerit dhe mulliri i cimentos

#### Emisionet e pluhurit të furra - mulliri i lëndës së parë

Vlerat mesatare mujore të emisioneve të pluhurit të furra - mulliri i lëndës së parë në Sharrcem, gjatë vitit 2020, kanë qënë të ulëta në krahasim me vlerën kufitare të emisioneve (VKE). Shih fig. 44.




Fig.44. Vlera mesatare mujore e emisioneve të pluhurit të furra - mulliri i lëndës së parë 2020

#### Emisionet e pluhurit te ftohësi i klinkerit dhe mulliri i cimentos

Vlen të theksohet se këtu merret për bazë vlera kufitare e emisioneve (VKE) 20 mg/Nm<sup>3</sup>. Vlerat mesatare mujore të emisioneve të pluhurit te ftohësi i klinkerit dhe mulliri i cimentos gjatë vitit 2020, janë të ulëta në krahasim me vlerën kufitare të emisioneve ( VKE ). Shih fig. 45.




Fig.45. Vlerat mesatare të emisioneve te pluhurit të ftohësi i klinkerit dhe mulliri i çimentos 2020

### Emisionet e SO<sub>2</sub> te furra – mulliri i lëndës së parë

Në figurën 46, janë paraqitur vlerat mesatare të emisioneve të SO<sub>2</sub> te furra – mulliri i lëndës së parë në Sharrcem. Sipas vlerësimeve të dhënave vlerat e SO<sub>2</sub> janë të ulëta në krahasim me vlerën kufitare të emisioneve (VKE). Vlerat me të ngritura vërehen gjatë muajve mars dhe shtator, por me të ulëta në krahasim me vlerat kufitare te lejuara.




Fig.46. Vlerat mesatare të emisioneve te SO<sub>2</sub> të furra - mulliri i lëndës së parë në Sharrcem 2020

## Emisionet e NOx te furra – mulliri i lëndës së parë

Vlera mesatare te emisioneve të NOx te furra – mullirit i lëndës së parë ,kanë rezultuar nën vlerën kufitare të emisioneve ( VKE ) gjatë vitit 2020. Pothuajse, vlerat mesatare të përafërta me vlerën e lejuar janë vlerësuar të jenë gjatë muajve janar, prill, maj, qershor, gusht, të 2020, por asnjëherë me tejkalime mbi vlerën mesatare te lejuar ( fig. 47).




Fig.47. Vlerat mesatare të emisionet të NOx te furra – mulliri i lëndës së parë 2020

#### 4. Investimet në përmirësimin e rrjetit për monitorimin e cilësisë së ajrit

Përcaktimit i rrjetit të monitorimit sipas Direktivës 2008/50 të "Linjës ajrore për Evropën" vendet e monitorimit do të rishikohen ose ri-përcaktohen në intervale të rregullta (minimumi pesë vite) për të siguruar se kriteret e zgjedhjes të qëndrojnë të vlefshme gjatë gjithë kohës.

Në përpjekjet e saj për të siguruar se zgjedhja e vendeve të mbetet e vlefshme gjatë gjithë kohës, MMPHI rriktoj rrjetin e monitorimit gjatë dy viteve të fundit 2019/2020, duke dislokuar tre stacione monitorimi (në Gjilan, Prizren dhe stacionin Drenas) nga vendet e mëparshme në ato të reja. Me mbështetjen e MCC / MFK, analizuesit e vjetëruar të monitorimit të ajrit janë zëvendësuar në 7 stacione të monitorimit të cilësisë së ajrit (Gjilan, Hani i Elezit, Brezovice, Prizren, Pejë, Mitrovice, Drenas), ndërsa trembëdhjetë furnizime të energjisë pa ndërprerje (UPS), trembëdhjetë sensor meteorologjike dhe regjistruarit e të dhënave, data logerat dhe kamerat e sigurisë me karta SIM të instaluar për të lejuar transmetimin e të dhënave. Një PC desktop me performancë të lartë u instalua në IHMK ,që monitoron të dhënat dhe imazhet nga të gjitha stacionet. Të 12 stacionet automatike dhe 1 stacioni i lëvizshëm fiks tani janë funksionale dhe AMMK / IHMK ka bërë mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre të rregullt.

Si rezultat i ndërhyrjes me investime nga Komisioni Evropian, JICA dhe MCC / MFK, MMPHI ka përmirësuar sistemin e komunikimit për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e ajrit. Të dhënat nga të gjitha stacionet transmetohen vazhdimisht te serverat e ASHI, një qasje e përhershme dhe direkte e stafit të IHMK. Punën me të lehtë e bëjnë edhe imazhet që merren nga kamerat e sigurisë të cilat mund të shikohen në distancë.

Përveç kësaj, gjatë vitit 2020 me mbështetjen e MCC / MFK, MMPHI ka përmirësuar vazhdimisht sistemin e komunikimit për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e ajrit që publikon të dhëna në kohë reale të cilësisë së ajrit dhe parashikimin e AQI përmes portalit kombëtar të cilësisë së ajrit <https://airqualitykosova.rks-gov.net/sq/>, dhe raportoi azhurnimin e të dhënave në Agjencinë Evropiane të Mjedisit (EEA) <https://airindex.eea.europa.eu/Map/AQI/Vieëer/>. Gjithashtu publiku mund të ketë qasje në indeksi e cilësisë e ajrit përmes aplikacionit të telefonit inteligjent.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese MMPHI ka monitoruar BTEX<sup>1</sup> në të gjitha stacionet e monitorimit të cilësisë së ajrit si dhe në 26 vendet e tjera, që në total ka mbledhur 456 mostra të BTEX të cilat janë analizuar në laboratorin e akredituar Gradko në Angli.

Gjatë vitit 2021, MMPHI planifikon të vazhdoj me ngritjen e numrit të vendeve(38) të cilat do të bëjnë monitorimin e BTEX. Një ashtu stafi i IHMK do të trajnohet të përdorë aparaturën e ICP-MS për përcaktimin e metaleve të rënda në ajër.

---

<sup>1</sup> BTEX: është një akronim që qëndron për Benzen, Toluen, Etilbenzen dhe Xylenes. Këto përbërje janë përbërje organike të paqëndrueshme (VOC) që gjenden në naftë dhe produktet e naftës siç është benzina. 38

## 5. Konkluzionet dhe rekomandimet

### 5.1. Konkluzione

Pas vlerësimit të të dhënave për cilësi të ajrit dhe emisioneve ndotëse për vitin 2020, janë nxjerrë konkluzionet dhe rekomandimet si me poshtë;

Është konstatuar se burimet ndotëse kryesore të ajrit për vitin 2020 në territorin e Kosovës janë ato ekzistuesit që janë përmendur edhe në raportet e mëhershme si;

- Termocentralet Kosova A dhe Kosova B
- Djegjet e vogla (ekonomit familjare, furrat e bukes, restaurantet etj.)
- Operatorët industrial dhe operatorët tjerë ekonomik (bizneset);
- Transporti rrugor
- Deponitë e mbeturinave urbane
- Bujqësia
- Gurëthyesit

Në vitin 2020, ashtu edhe në vitet paraprake, stinët vjeshtë-dimër kanë rezultuar më ndotje më të lartë krahasim me stinët tjera të vitit. Ky nivel i ngritur i vlerave të ndotëseve në ajër është si rezultat djegieve nga industria, djegiet e lëndës fosile për djegie nga ekonomit familjare, transporti etj. Në këtë sezonë, kushtet meteorologjike ndikojnë shumë në cilësinë e ajrit përshkak të lagshtisë së ajrit, të reshurave atmosferike, mjegullave etj.

Parametrat me vlera me të larta në ajër të cilë janë monitoruar nga stacionet monitoruese është vlersuar së janë grimca e pluhurit PM10/PM2.5.

Në zonën e Aglomeracionit të Prishtinës( AKS1), vlerat e PM10 dhe PM2.5 kanë treguar tejkalime mbi vlerat kufitare në stacionet monitoruese IHMK, Rilindje, Obiliq dhe Dardhishtë. Tejkalimet ishin me të theksuara gjatë muajve janar, shkurt, nëntor dhe dhjetor. në stacionet e IHMK, Rilindje, Obiliq dhe Dardhishtë. Nga të gjitha stacionet e kësaj zone, janë regjistruar 280 dite më tejkalime të vlerave gjatë vitit 2020. Parametrat tjerë si SO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub>, CO, kanë rezultuar me vlera me të ulëta se sa është lejuar sipas standardeve. Vlerat e NO<sub>2</sub> më përjashtim të muajt janar, kanë rezultuar me të ulët krahasim me vlerat e lejuara.

Në zonën ZKS1, me përjashtim të parametrave të PM10, PM2.5, të cilat janë vlersuar me vlera me të lartë gjatë muajve të stinës vjeshtë-dimër, parametrat tjerë si SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub>, CO, O<sub>3</sub>, kanë rezultuar nën vlerat standard. Vetëm gjatë vitit 2020, në këtë zonë janë regjistruar 323 ditë me tejkalime të vlerave të PM10.

Që nga viti 2018-2020, trendi i nivelit ndotës të parametrave si PM10, PM2.5, SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub>, O<sub>3</sub>, CO, ka treguar rënie progresive. Kjo tregon së përmirësimet në infrastrukturë dhe investimet në mjedis kanë ndikuar që këto ndotës të jenë me nivele me të ulët në ajër.

Edhe në vitin 2020, si nga viti paraprak emisionet ndotëse të pluhurit nga Termocentrali B, kanë qënë shumë të lartë nëse merren si krahasim me vlerat e pluhurit në Termocentralin A. Shkarkimet e SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub> nga dy termocentralet gjatë gjithë vitit 2020 kanë qënë mbi vlerën e lejuar sipas standardeve.

Emisionet ndotëse të pluhurit, SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub>, CO nga Feronikeli, kanë qënë nën vlerat e lejuara gjatë gjithë vitit 2020. Nga operatori i Sharrcemit, shkarkimet e ndotëseve në ajër si pluhurit, SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub>, gjatë gjithë vitit 2020, kanë qënë nën vlerat e lejuara sipas standardeve.

## 5.2. Rekomandime

Gjëndja e ajrit, përkundër trendit të përmirësimit nga parametrat ndotës, akoma tregon një gjëndje jo të mirë nga cilësia. Nga vlerësimi i të dhënave për gjendjen e ajrit gjatë vitit 2020, janë dhënë rekomandimet të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit, si me poshtë;

- Zbatimi i legjislacionet për mbrojtjen e ajrit;
- Të implementohen Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e ajrit;
- Të hartohen Plane Lokale të Veprimit në Mjedis në të gjitha komunat;
- Të mirëmbahen dhe fuqizohen edhe me shumë funksionalizimi i sistemi nacional për monitorimit e cilësisë së ajrit;
- Të obligohen të gjithë operatorët ndotës të respektojnë normat standarde të shkarkimit në ajër;
- Të obligohen të gjithë operatorët ndotës për dërgimin e të dhënave për emetimet në ajër si një obligim ligjor;
- Të bëhet reduktimi maksimal i shfrytëzimit të lëndëve djegëse fosileve;
- Të zbatohen normat e lejueshme të shkarkimit në ajër nga automjetet;
- Të zgjerohet sistemi ekzistues i ngrohjes qendrore dhe të zhvillohen sisteme të reja;
- Te zbatohen subvencione për ekonomitë familjare që përmrësojnë sistemet e ngrohjes;
- Të zbatohen suvencione për ekonomitë familjarë për izolim termik të ndërtesave;
- Të investohet më shumë në rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta në viset urbane;
- Të favorizohet dhe fuqizohet transportit publik në vendbanimet urbane,
- Mirëmbajtja me e mirë e infrastrukturës rrugore dhe pastrimi i rregulltë i tyre,
- Menaxhimi me i mirë i deponive të mbeturinave dhe eliminimi i deponive ilegale dhe industriale;
- Ndalimi i djegies së mbeturinave urbane, pyjeve apo edhe fushave bujqësore etj.
- Të realizohen edhe me shumë projekte specifike me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ajrit.

## **6.Lista e shkurtesave, figurave dhe tabelave**

### **6.1. Lista e shkurtesave**

AMMK - Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

IHMK - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

MCC - Millennium Challenge Corporation

TCA - Termocentrali Kosova A

TCB - Termocentrali Kosova B

JICA - Agjencioni Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar

MFK - Millennium foundation Kosova

MMPHI - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastruktures

ASHI - Agjencia e Shoqërsisë së Informacionit

AQI - Indeksi i cilësisë së ajrit

EEA - Agjencia Evropiane e Mjedisit

BTEX - Benzen, Toluen, Etilbenzen dhe Xylenes

## 6.2. Lista e figurave

- Figura 1. Vlerat mesatare vjetore të PM10 në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020
- Figura 2. Vlerat mesatare vjetore të PM2.5 në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020
- Figura 3. Vlerat mesatare vjetore të Ozonit në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020
- Figura 4. Mesataret vjetore të NO<sub>2</sub> në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020
- Figura 5. Mesataret vjetore të SO<sub>2</sub> në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020
- Figura 6. Mesataret vjetore të CO në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020
- Figura 7. Mesataret vjetore të PM10 në ZKS1 gjatë vitit 2020
- Figura 8. Mesataret vjetore të PM2.5 në ZKS1 gjatë vitit 2020
- Figura 9. Mesataret vjetore të Ozonit në ZKS1 gjatë vitit 2020
- Figura 10. Mesataret vjetore të NO<sub>2</sub> në ZKS1 gjatë vitit 2020
- Figura 11. Mesataret vjetore të SO<sub>2</sub> në ZKS1 gjatë vitit 2020
- Figura 12. Mesataret vjetore të CO në ZKS1 gjatë vitit 2020
- Figura 13. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në Stacionin e IHMK-së
- Figura 14. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Rilindjes
- Figura 15. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Obiliqit
- Figura 16. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Dardhishtës
- Figura 17. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Palaj
- Figura 18. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Drenasit
- Figura 19. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në stacionin e Mitrovicës
- Figura 20. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në Stacionin e Pejës
- Figura 21. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në Stacionin e Prizrenit
- Figura 22. Vlerat mesatare mujore të PM10 dhe PM2.5 në Stacionin e Hanit të Elezit
- Figura 23. Vlerat mesatare mujore për PM10 gjatë vitit 2020 për të gjitha stacionet monitorues
- Figura 24. Vlerat mesatare mujore të PM2.5 për të gjitha stacionet për vitin 2020
- Figura 25. Trendi i vlerave të SO<sub>2</sub> për vitet 2013-2020
- Figura 26. Trendi i vlerave të NO<sub>2</sub> për vitet 2013-2020
- Figura 27. Trendi i vlerave të O<sub>3</sub> për vitet 2013-2020
- Figura 28. Trendi i vlerave të CO për vitet 2013-2020
- Figura 29. Trendi i vlerave të PM10 për vitet 2013-2020
- Figura 30. Trendi i vlerave të PM2.5 për vitet 2013-2020
- Figura 31. Vlerat mesatare të emisionet të pluhurit në TCA dhe TC B 2020

Figura 32. Vlerat mesatare të emisionet te SO<sub>2</sub> në TCA & TC B 2020

Figura 33. Emisionet e NO<sub>x</sub> në TCA dhe TC B janar – dhjetor 2020

Figura 34. Vlera mesatare mujore e emisioneve të pluhurit në furrën rrotulluese - 2020

Figura 35. Vlera mesatare mujore te emisioneve të CO në furrën rrotulluese - 2020

Figura 36. Vlera mesatare mujore e emisioneve të SO<sub>2</sub> në furrën rrotulluese – 2020

Fig.37. Vlera mesatare mujore e emisioneve të NO<sub>2</sub> në furrën rrotulluese \_ 2020

Fig.38. Vlera mesatare mujore e emisioneve të pluhurit në konvertor - 2020.

Fig.39. Vlerat mesatare mujore e emisioneve të CO në konvertor - 2020

Fig.40. Vlera mesatare mujore e emisioneve të SO<sub>2</sub> në konvertor janar - dhjetor 2020

Fig.41. Vlera mesatare mujore e emisioneve të NO<sub>2</sub> në konvertor - 2020.

Fig.42. Vlerat mesatare mujore te emisioneve të pluhurit në furrën elektrike 1- 2020.

Fig.43. Vlerat mesatare mujore te emisioneve të pluhurit në furrën elektrike 2- 2020.

Fig.44. Vlera mesatare mujore e emisioneve të pluhurit të furra - mulliri i lëndës së parë 2020

Fig.45. Vlerat mesatare të emisioneve te pluhurit të ftohësi i klinkerit dhe mulliri i çimentos

Fig.46. Vlerat mesatare të emisioneve te SO<sub>2</sub> të furra - mulliri i lëndës së parë në Sharrcem 2020

Fig.47. Vlerat mesatare të emisionet të NO<sub>x</sub> te furra – mulliri i lëndës së parë 2020

### 6.3. Lista e tabelave

Tabela 1. Pragjet alarmuese për dyoksidin e squfurit (SO<sub>2</sub>) dhe dyoksidin e azotit (NO<sub>2</sub>)

Tabela 2. Pragjet e alarmit për PM<sub>10</sub> dhe Ozon (O<sub>3</sub>)

Tabela 3. Normat e cilësisë së ajrit (UA Nr.02/2011)

Tabela 4. Indeksi i cilësisë së ajrit për parametrat e monitoruar

Tabela 5. Stacionet monitoruese për cilësinë e ajrit-Aglomeracioni AKS 1 dhe Zona ZKS 1

Tabela 6. Mesataret mujore të PM<sub>10</sub> në Aglomeracionin AKS1, 2020

Tabela 7. Vlerat mesatare mujore të PM<sub>2.5</sub> në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020

Tabela 8. Mesatarja vjetore e Ozonit në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020

Tabela 9. Mesatarja mujore të NO<sub>2</sub> në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020

Tabela 10. Mesataret mujore të SO<sub>2</sub> në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020

Tabela 11. Mesataret vjetore të CO në Aglomeracionin AKS1 gjatë vitit 2020

Tabela 12. Ditët me tejkalime për PM<sub>10</sub> gjatë vitit 2020

Tabela 13. Mesataret mujore të PM<sub>10</sub> në ZKS1 gjatë vitit 2020

Tabela 14. Mesataret mujore të PM<sub>2.5</sub> në ZKS1 gjatë vitit 2020

Tabela 15. Mesataret mujore të Ozonit në ZKS1 gjatë vitit 2020

Tabela 16. Mesataret mujore të NO<sub>2</sub> në ZKS1 gjatë vitit 2020

Tabela 17. Mesataret vjetore të SO<sub>2</sub> në ZKS1 gjatë vitit 2020

Tabela 18. Mesataret vjetore të CO në ZKS1 gjatë vitit 2020

Tabela 19. Ditët me tejkalime për PM<sub>10</sub> gjatë vitit 2020

Tabela 20. Vlerat kufitare të emisioneve sipas UA 06/2007 dhe “Lejes Mjedisore të Integruar” për Ferronikelin

## **Raporti vjetor për gjendjen e ajrit në Kosovë 2020**

është përgatitur nga Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit e AMMK në mbështetje edhe të njësive tjera të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Raportin e përgatiten:

Tafë Veselaj PhD - udhëheqës i sektorit të monitorimit,  
Ajet Mahmuti - zyrtar për monitorim të ajrit dhe zhurmës

*Adresa e AMMK-së:*

*Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04*

*Tel. +381 38 200 33 228 , email: [ammk@rks-gov.net](mailto:ammk@rks-gov.net)*

*Prishtinë, Prill 2021*